

Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në Universitetin Ca'Foscari të Venecias në Itali për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Ca' Foscari të Venecias në Itali, në kuadër të programit Erasmus +, për stafin akademik të UT-së për mësimdhënie dhe për studentët Ph.D., për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;
- Shkëmbimin e studentëve Ph.D.;

Fusha e studimit:

-Gjuhë dhe Letërsi;

Katalogu i kurseve:

<https://www.unive.it/pag/17839/>

Kohëzgjatja e bursave:

- Doktoraturë (1 semestër);
- Shkëmbimi i stafit akademik për trajnim (5 + 2 ditë).

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët/ 160 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe / ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin **Ph.D.:**

- CV + publikime (në gjuhën angleze/italiane sipas formatit Europass);

- Formulari i aplikimit, sipas linkut:

http://www.unitir.edu.al/images/Application_Form_Ca_Foscari.docx

- Plan Mobiliteti, sipas linkut:

http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Paln_for_PhD_Ca_Foscari.doc

- Plan kërkimi;

- Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);

- Listë notash doktore + master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);

- Letër motivimi (në gjuhën angleze/italiane);

- Letër suporti nga një pedagog në Universitetin Ca'Foscari (mund të kontaktoni tek: international.cooperation@unive.it duke dërguar CV dhe planin e kërkimit);

- Certifikata e gjuhës së huaj niveli B2 (Italisht/Anglisht)

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze/italiane sipas formatit Europass);

- Formulari i aplikimit, sipas linkut:

http://www.unitir.edu.al/images/Application_Form_Ca_Foscari.docx

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze/italiane);

- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze/italiane (niveli B2);

- Plan pune në gjuhën Angleze/Italiane;
- Vërtetim punësimi në gjuhën Shqipe dhe të përkthyer në gjuhën Anleze/Italiane;
- Letër suporti nga një pedagog në Universitetin Ca'Foscari (mund të kontaktoni tek: international.cooperation@unive.it duke dërguar CV dhe planin e punës);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë ose jo një bursë shkëmbimi Erasmus+ (nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit, sipas linkut:

http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Plan_Ca_Fiscari_for_academic_staff.doc

Afati për aplikim: 25 Mars 2019

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!